



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Udhëzues Pune

Për Caktimin e Shtetit të Kryerjes së Dënimit

Lëshuar nga:	Kryetarja, Dhomat e Specializuara të Kosovës
Data e lëshimit:	19 maj 2022
Data e hyrjes në fuqi:	19 maj 2022
Zëvendëson:	Nuk ka
Numri:	KSC-BD-45

PËRMBAJTJA

KREU I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
NENI 1	QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI.....	2
NENI 2	PËRKUFIZIME	2
KREU II	KOMUNIKIMI I ADMINISTRATORIT ME SHTETET DHE RAPORTI PËR KRYETARIN	3
NENI 3	KËRKESA PARAPRAKE PËR INFORMACION	3
NENI 4	INFORMACIONI QË I JEPET SHTETIT (SHTETEVE).....	3
NENI 5	RAPORTI PËR KRYETARIN	3
KREU III	CAKTIMI I SHTETIT TË KRYERJES SË DËNIMIT	4
NENI 6	CAKTIMI I SHTETIT TË KRYERJES SË DËNIMIT	4
NENI 7	KËRKESË DREJTUAR SHTETIT TË KRYERJES SË DËNIMIT.....	4
NENI 8	NJOFTIMET NGA ADMINISTRATORI	4
NENI 9	KTHIMI PËR RISHQYRTIM TE KRYETARI	5
KREU IV	DISPOZITA PËRFUNDIMTARE.....	5
NENI 10	MIRATIMI DHE NDRYSHIMET	5
NENI 11	VERSIONI AUTENTIK DHE HYRJA NË FUQI	5

KREU I Dispozita të përgjithshme**Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

- Kryetarja miraton këtë Udhëzues Pune, në konsultim me Administratoren, në pajtim me nenet 19(6) dhe 50 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 13(1)(g) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).
- Ky Udhëzues Pune rregullon caktimin e shteteve ku do të kryejnë dënimin personat e dënuar nga Dhomat e Specializuara, në përputhje me Marrëveshjen Ndërkombëtare midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian të vitit 2014, nenet 162(4) dhe (8) të Kushtetutës së Kosovës, nenet 50(1) dhe 57 të Ligjit dhe rregullën 166 të Rregullores.

Neni 2 Përkufizime

- Termet e përdorura në këtë Udhëzues Pune kanë kuptimin që u jep Ligji, rregulla 2 e Rregullores dhe paragrafi 2 më poshtë.
- Krahas tyre, përdoren edhe përkufizimet e mëposhtme:

Person i dënuar një person i dënuar nga Dhomat e Specializuara;

Shteti i kryerjes së dënimit një shtet i caktuar nga Kryetari i Dhomave të Specializuara, që ka shprehur gatishmërinë të pranojë personin e dënuar nga Dhomat e

Specializuarë, për zbatimin e dënimit me burgim dhe në bazë të një marrëveshjeje me Dhoma e Specializuarë.

KREU II Komunikimi i Administratorit me shtetet dhe raporti për Kryetarin

Neni 3 Kërkesa paraprake për informacion

1. Pasi Trupi Gjykses shqipton vendimin me anë të të cilit dënon të akuzuarin, Administratori komunikon me shtetet në mënyrë konfidenciale, lidhur me gatishmërinë e tyre për të pranuar personin e dënuar për zbatimin e dënimit me burgim.
2. Administratori u kërkon shteteve që brenda një date të caktuar të informojnë lidhur me gatishmërinë e tyre për të pranuar personin e dënuar.

Neni 4 Informacioni që i jepet shtetit (shteteve)

1. Administratori, në mënyrë konfidenciale, i jep shtetit që ka shprehur gatishmërinë të pranojë personin e dënuar, informacionet përkatëse lidhur me atë person.
2. Administratori, ndër të tjera, jep dokumentet e mëposhtme:
 - a. një kopje të legalizuar të aktgjykimit;
 - b. aty ku është e mundshme, një deklaratë ku përcaktohet kohëzgjatja e mbetur dënimit, në qoftë se personi i dënuar tashmë ka kryer një pjesë të tij, përfshirë edhe informacion lidhur me paraburgimin; dhe
 - c. çdo dokument tjetër të rëndësishëm, përfshirë:
 - (1) kopje të legalizuara të dokumenteve të identifikimit të personit të dënuar, që kanë në zotërim Dhoma e Specializuarë; dhe
 - (2) sipas rastit, si dhe duke mbajtur parasysh kushtet e konfidencialitetit, dosjen mjekësore të të dënuarit si dhe çdo rekomandim për trajtim mjekësor në shtetin e kryerjes së dënimit.

Neni 5 Raporti për Kryetarin

1. Pas shpalljes së aktgjykimit të formës së prerë dhe marrjes së njoftimit nga një shtet lidhur me gatishmërinë për të pranuar personin e dënuar, Administratori i dorëzon Kryetarit një raport konfidencial.
2. Në rastet kur më shumë se një shtet ka shprehur gatishmërinë të pranojë personin e dënuar, në raport renditen të gjitha ato shtete dhe përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - a. gjendja civile e personit të dënuar, personat në ngarkim të tij dhe të afërm të tjerë, vendbanimi/vendbanimet e zakonshme dhe, për aty sa është e mundshme dhe aty ku është e përshtatshme dhe e realizueshme, mjetet financiare që mund të jenë të disponueshme për vizitat tek personi i dënuar;
 - b. nëse pritet që personi i dënuar të paraqitet si dëshmitar në procese të tjera para Dhomave të Specializuara;
 - c. sipas rastit, dosja mjekësore e personit të dënuar;
 - d. gjuhët që flet personi i dënuar;

- e. kushtet e përgjithshme të burgimit si dhe rregullat e zbatueshme për sigurinë dhe lirinë në shtetin (shtetet) në fjalë;
- f. legjislacioni i shtetit (shteteve) sa i përket lirimit të parakohshëm, faljes, apo uljes së dënimit;
- g. nëse shteti (shtetet) pajtohet të mundësojë qëndrimin e personit të dënuar në atë shtet (ato shtete) pas përfundimit të dënimit, në qoftë se personi i dënuar për arsye sigurie nuk mund të kthehet menjëherë në shtetin ku ka statusin e banorit të ligjshëm, ndërkohë që gjendet zgjidhje për riatdhesimin e atij personi;
- h. mendimet përkatëse që personi i dënuar i ka shprehur Administratorit përpara paraqitjes së raportit; dhe
- i. çfarëdo informacioni tjetër që Administratori gjykon se e ndihmon Kryetarin në marrjen e vendimit për caktimin e shtetit të kryerjes së dënimit.

KREU III Caktimi i shtetit të kryerjes së dënimit

Neni 6 Caktimi i shtetit të kryerjes së dënimit

1. Kryetari cakton shtetin e kryerjes së dënimit bazuar në raportin e Administratorit, si dhe në bazë të çdo informacioni tjetër të marrë.
2. Përpara se të marrë vendimin për caktimin e shtetit të dënimit, Kryetari mund të konsultohet me gjykatësit e panelit (paneleve) që kanë shqiptuar apo kanë lënë në fuqi dënimin, mund të marrë mendimet e personit të dënuar, të Prokurorit të Specializuar si dhe mund të konsultohet më tej me Administratorin.
3. Gjatë marrjes së vendimit për caktimin e shtetit të kryerjes së dënimit, Kryetari merr parasysh nëse është e dëshirueshme që dënimi të kryhet në shtete që janë afër, ose ku kanë mundësi të shkojnë, të afërmit e personit të dënuar.
4. Kryetari mund të vendosë të mos e bëjë publik vendimin lidhur me caktimin e shtetit të kryerjes së dënimit.

Neni 7 Kërkesë drejtuar shtetit të kryerjes së dënimit

Në pajtim me nenin 6, Administratori i komunikon shtetit të kryerjes së dënimit vendimin e Kryetarit shoqëruar me një kërkesë drejtuar qeverisë për zbatimin e dënimit.

Neni 8 Njoftimet nga Administratori

1. Nëse shteti i caktuar pranon kërkesën e Dhomave të Specializuara për të pranuar personin e dënuar, Administratori njofton Kryetarin dhe, aty ku është e mundshme dhe e realizueshme, gjykatësit e panelit (paneleve) që shqiptuan ose lanë në fuqi dënimin.
2. Administratori e informon personin e dënuar për:
 - d. shtetin e caktuar për zbatimin e dënimit me burgim;
 - e. marrëveshjen midis Dhomave të Specializuara dhe shtetit të kryerjes së dënimit lidhur me zbatimin e dënimit; dhe
 - f. çdo informacion apo aspekt tjetër të rëndësishëm.

Neni 9 Kthimi për rishqyrtim te Kryetari

Nëse shteti i zgjedhur refuzon kërkesën e Dhomave të Specializuara për pranimin e personit të dënuar, Administratori ia kthen çështjen Kryetarit, që cakton një shtet tjetër në përputhje me këtë Udhëzues Pune.

KREU IV Dispozita përfundimtare

Neni 10 Miratimi dhe ndryshimet

Kryetarja miraton këtë Udhëzues Pune dhe mund ta ndryshojë atë *proprio motu* ose me propozim të Administratores.

Neni 11 Versioni autentik dhe hyrja në fuqi

1. Versioni autentik i këtij Udhëzuesi Pune është versioni në gjuhën angleze.
2. Ky Udhëzues Pune dhe çdo ndryshim i tij hyn në fuqi në ditën e publikimit.

Hagë, Holandë

19 maj 2022

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Kryetare